

E PREMTIA E NDRITESHME “BURIMI JETEDHENES”



Si është traditë e premtia e javës së ndritëshme në Mitropolinë e Shenjtë të Korçës është monoklisi në katedralen historike “Burimi Jetëdhënës” (Kisha e Metropolisë), të qytetit të Korçës. Besimtarë të shumtë sëbashku me klerikët mbushën kishën, duke nderuar të Tërëshenjtën, si burim të mirash, dhe si ndërmjetare të pandërprerë ndaj Krijuesit. Me sigurinë, se ajo është Nëna e Atij që u Ngjall së vdekurësh, dhe nërmjetare e sigurtë për ata që e lusin besërisht.

KRISHTI U NGJALL!





